

AKT- THEMELIMI

I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

“MEA SERVICE” shpk

Ne Durres , sot me date, 07/01/2021 (dymije e njezet e nje), me cilësinë e “ Ortakut te vetem themelues” Z. Raffaele Matino, madhor,dhe me zotesi juridike dhe per te vepruar.

i cili me cilesine e “Ortakut te vetem themelues” kerkoi redaktimin e ketij Akti Themelimi, nepermjet te cilit deklaron se me vullnet te lire te plete e te singerte, dhe inisiativen e lire private, mbeshtetur ne Kushtetuten e Republikes se Shqiperise dhe Kodin Civil ne fuqi, ne ligjin 9901 date 14.04.2008, “Per tregetaret dhe shoqerite tregetare”, ligjin nr.9723, date 03.05.2007 “Per Qendren Kombetare te Regjistrimit”, ne ate Doganor,Fiskal e Tatimor, krijon shoqerine tregetare, me pergjegjesi te kufizuar, “MEA SERVICE “shpk

KREU I

Neni 1

Krijimi

Shoqeria “MEA SERVICE “shpk

Eshte person juridik i te drejtes shqiptare, Shoqeri me pergjegjesi te kufizuar (me poshte e quajtur “Shoqeria”).

Neni 2

Personaliteti juridik

Shoqeria fiton personalitetin juridik pasi te jete regjistruar ne QKR, ne perputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara me ligj. Shoqeria “MEA SERVICE “shpk, eshte nje shoqeri tregetare, e themeluar nga Z. **Raffaele Matino**, i cili nuk per gjigjet per detyrimet e shoqerise tregtare dhe mbulon personalisht humbjet e shoqerise deri ne pjesen e pashlyer te kontributeve te nenshkruese. Kontributi i ortakeve perben kapitalin e rregjistruar te Shoqerise.



Neni 3

Selia

Shoqëria e ka selin në **Lagja nr. 4, Rruga Egnatia, objekt me numer pasurie 2/395, zona kadastrale 8514, Durrës.**

Shoqeria mund te ndryshoje seline e saj, te hape zyra perfaqesie, dege, te krijoje filial, si brenda ashtu edhe jashte Republikës se Shqipërise, vetem me vendim te Assamblese se ortakeve.

Neni4

Objekti i veprimtarise

- Import export dhe sherbime nga te tretet. Punime rrobaqepesie (Fason). Tregtim te veshjeve tekstile

Neni 5

Kohezgjatja

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e tij per një periudhe kohore te pakufizuar, duke filluar nga data e regjistrimit ne Qendren Kombetare te Regjistrimit.

KREU II

Kapitali

Neni 6

Kapitali themeltar

Kapitali themeltar fillestare i shoqërisë është 100 000 (njeqindë mijë) lekë,

Pjesemarrja themeluesve ne kapitalin e shoqerise eshte ne perputhje me kontributet e tyre te meposhtme:

- 1- Ortaku themlues **Z Raffaele Matino**: zoteres i 1 (nje) kuote me vlore te per gjithshme 100,000 leke, qe perbene 100 % te kapitalit themeltare te shoqerise.



Kapitali themltare eshte i nenshkuar plotësisht nga ortaket I vetem themelues ne masën 100% Pjesët e kapitalit themeltar nuk mund të përfaqësohen nga letra me vlerë të tregtueshme .

Kontributi I ortakeve mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të lujtshme / të palujtshme apo të drejta)

Ortaket përgjigjet për humbjet e shoqërisë përkundrejt të tretëve deri ne vlerën e kontributit të kapitalit themeltar të shoqërisë ;

Neni 7

Transferimi i kapitalit

Kuota e kapitalit te nje shoqerie me perjegjesi te kufizuar e te drejtat qe rrjedhin prej tyre mund te fitohen apo kalohen nepermjet:

- a) Kontributit ne kapitalin e shoqerise
- b) Shitblerjes
- c) Trashegimise
- d) Dhurimit
- e) Çdo menyre tjeter te parashikuar me ligj.

Ne rastin e kalimit te kuotave me kontrate, kontrata duhet te behet me shkrim.

Personi qe kalon kuoten dhe ai qe e fiton ate per gjigjen ne menyre solidare ndaj shoqerise per detyrimet qe rrjedhin nga zoterimi i kuotes, nga çasti i kalimit te kuotave, deri ne çastin e regjistrimit te kalimit te saj ne Qendren Kombetare te Regjistrimit, sipas nenit 43 te ligjit nr.9723, date 03.05.2007 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit". Regjistrimi i kalimit te kuotave ka efekt deklarativ.Pjeset e kapitalit themeltar jane lirisht te transferueshme me rruge trashegimie.

KREU II

ORGANET VENDIMMARRESE DHE DREJTUESE

Neni 8

Organi Vendimmarres

Assambleja e ortakeve eshte organi vendimmarres i shoqerise. Assambleja e ortakeve eshte organi vendim marres i shoqerise qe miraton çdo ndryshim te statutit sipas modaliteve te percaktuara ne ligj. Çdo ndryshim ne statut duhet te depozitohet prane QKR per te pasqyruar ndryshimet ne skeden e shoqerise.

Asambleja e ortakeve vendos per çeshtje si :



- a) Percaktimi i politikave tregetare te shoqerise
- b) Emerimin dhe shkarkimin e administratoreve
- c) Emerimin e shkarkimin e likuiduesve dhe te eksperteve kontabel te autorizuar
- d) Percaktimin e shperblimeve
- e) Mbikqyrjen e zbatimit te politikave tregetare nga administratoret, perfshire perqatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise;
- f) Perfaqesimin e shoqerise ne gjykate dhe ne procedimet e tjera ndaj administratoreve;
- g) Miratimin e rregullave procedural te mbledhjeve te asamblese;

Te gjitha vendimet e marra nga Assambleja e ortakeve regjistrohen ne një register te vendimeve, te dhenat e te cilit nuk mund te ndryshohen ose te fshihen. Duhen regjistruar ne vecanti, por pa u kufizuar ne to, vendimet per :

- a) Miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise;
- b) Shperndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve;
- c) Investime;
- d) Vendimet per riorganizimin dhe prishjen e shoqerise.

Vendimet e parregjistruara ne registrin e vendimeve jane absolutisht te pavlefshme. Shoqeria nuk mund t'i kundrejtoje pavlefshmerine te tretit, qe ka fituar te drejta ne mirebesim , perveç rastit kur shoqeria provon se i treti ka pasur dijeni per pavlefshmerine, apo ne baze te rrethanave te qarta nuk mund te mos kishte pasur dijeni per te.

Neni 9

Administrimi

Administrator i shoqerise "MEA SERVICE "shpk, caktohet Brenda ortakerise, ortaku themelues Z. Raffaele Matino, i cili emerohet per një afat 5 vjeçar me te drejte riparteritje.

Administratori emerohet dhe shkarkohet me vendim te Assambleja e ortakeve te shoqerise.

Neni 10

Kompetencat

Administratori ka te drejte e detyrohet te :

- a) Kryeje te gjitha veprimet e administrimit te veprimtarise tregetare te shoqrise, duke zbatuar politikat tregetare, te vednosura nga asambleja e per gjithshme;
- b) Perfaqesoje shoqerine tregetare;
- c) Kujdeset per mbajtjen e sakte e te rregullt te dokumentave dhe te librave kontabel te shoqerise;



- d) Pergatise dhe nenshkruaj bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurise se veprimtarise dhe se bashku me propozimet per shpendarjen e fitimeve i paraqesin keto dokumenta perpara asamblese se per gjithshme per miratim
- e) Krijoi nje sistem paralajmerimi ne kohen e duhur per rrethanat qe kercenojne mbarevajtjen e veprimtarise dhe ekzistencen e shoqerise
- f) Kryej regjistrimet dhe dergojne te dhenat e detyrueshme te shoqrise sic parashikohet ne ligjin per QKR.
- g) Raportoi perpara asmbleses se per gjithshme ne lidhje me zbatimin e politikave tregetare dhe me realizimin e veprimeve te posacme me rendesi te vecante per veprimtarine e shoqerise tregetare.

Administratori eshte i detyruar te therrase ne mbledhjen e asamblese ne rastet kur :

Sipas bilancit vjetor apo raporteve te ndermjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku qe aktivet e Shoqërisë nuk I mbulojnë detyrimet e kerkueshme Brenda 3 muajve në vazhdim dhe kur shoqëria , brenda 2 viteve te para pas regjistrimit te saj,propozon te bleje nga nje ortak pasuri,qe kane vlere me te larte se 5 per qind te aseteve te shoqerise,qe rezulton ne pasqyrat e fundit financiare te certifikuara. Administratoret , si se bashku edhe vecas njeri tjetrit, kane te drejt te kryejn te gjitha veprimet e administrimit te zakonshem e te jashtzakonshem.

Administratoret e perfaqesojne Shoqerine perpara te gjithe personave fizike e juridike, publike dhe /ose private vendas apo te huaj, autoriteteteve shteterore shqiptare apo te huaja, perfshi ketu autoritetet gjyqesore te gjitha shkalleve. Administratoret kane te gjitha kompetencat per te vepruar ne marredhenie me te tretet ne emer te Shoqerise, ne te gjitha rrethanat me perjashtim te kompetencave qe ligji ja jep shprehimisht ortakeve te Shoqerise.

Administratoret angazhojn Shoqerine ne marredheniet me te tretet nepermjet akteve qe jane ne perputhje me objektin e saj.

Shoqeria nuk mer persiper pasojat ndaj te treteve kur ajo provon se te tretet e dinin qe akti I administratorit e kalonte objektin e Shoqerise ose per te tretet nuk mund ta injoronin kete akt ne rrethanat e dhena, duke patur parasysh faktin se vetem shpallja e statutit nuk eshte prove e mjaftueshme.

Neni 11

Viti Financiar

Viti Financiar I Shoqerise fillon me 1 janar dhe perfundon ne 31 dhjetor. Perjashtimisht , viti I pare Financiar fillon nga data e regjistrimit te Shoqerisë ne QKR dhe mbylljet ne 31 dhjetor

Neni 12

Shperndarja ose prishja e Shoqerise mund te behet ne cdo kohe:

- a) kur mbaron kohezgjatja e parashikuar ne themelimin e saj
- b) me vendim te ortakeve themelues
- c) me hapjen e procedurave te falimentimi
- d) nese nuk ka kryer veprimitari tregtare per 2 vjet dhe nuk eshte njoftuar pezullimi I veprimitarise ne perputhje me piken 3 te nenit 43 te ligjit nr. 9723 , date 3.5.2007 "Per Qendren Kombtare te Regjistrimit"
- e) me vendim te Gjykates

Ne kete rast Asamblea merr vendim me shkrim ne te cilin parashikon menyren e likuidimit te Shoqerise, duke caktuar nje apo disa likuidatore dhe shenuar ne cdo dokument te nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emertesen shtese " shoqeri ne likuidim e siper"

Neni 13

Baza ligjore

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e tij ne perputhje te plote me kete akt themelimi dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Për sa nuk parashikohet ne kete akt themelimi, do te zbatohen dispozitat e ligjiut "Per tregtaret dhe shoqerit tregtare", Kodit Civil dhe cfaredo ligji tjeter specifik ne Republiken e Shqiperise

Neni 14

Dispozita perfundimtare

Ky akt themelimi u redakta ne 4 (kater) ekzemlare ne gjuhen shqipe, me permbajtje dhe vlera te njejtë juridike.

Akti I mesiperm pasi miratohet ne parim dhe nen per nen nga Ortaket themelues te shoqerise tregtare nenshkruehet ne te gjitha kopjet duke vendosur emrin , mbiemrin dhe firmen e tij origjinale .

ORTAKET THEMELUES

Z. Raffaele Matino

MATINO RAFFAELE
elmo Raffaele